

VENDIM
Nr.940, datë 4.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2009, në ministrinë dhe institucionet qendrore, bëhet 89 882 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Në numrin e punonjësve, të miratuar për vitin 2009:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t’i shtohen edhe 10 veta, për sistemin e arkivës;

b) Ministrisë së Mbrojtjes t’i pakësohen 12 veta, si pasojë e kalimit të administrimit të Spitalit Ushtarak të Gjirokastrës, pranë Ministrisë së Shëndetësisë;

c) Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit t’i shtohen 3 veta, si rezultat i shtimit të funksioneve, zëvendësministër, sekretar dhe shofer.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ministrinë e përmendura në pikën 2 të vendimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet financiare për shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi, nisin nga data 13.5.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Viti 2009
-----	--------------------------	-----------

3	Kryeministria	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	784
	- Drejtoria e Standardeve	18
	- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	135
	- Drejtoria e Metereologjisë e Kalibrimit	110
	- Qendra Kombëtare e Licencimit	35
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga e cila:	2 198
	- Bordet e kullimit	650
	- Agjencia e pagesave	86
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 363
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3 203
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1 062
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1 616
	- Drejtoria e Përgjithshme Parandalimit Pastrimit Parave	26
	- Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39.231
	Parauniversitar	38 241
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 103
13	Ministria e Shëndetësisë	3 530
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila	5 026
	- Avokati i Shtetit	55
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
	- Shërbim i Provës	50
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
	Ambasadat dhe përfaqësitë	428
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13 305
	-Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11 779
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	31
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 434
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 399
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integrimit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	103
	-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	38
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20
	Total numri punonjësve	86 707
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	3 175
	Total numri punonjësve buxhetorë	89 882